



Ftesë për Aplikim në Raundin e 6-të të

Skemës së Celulës së të Rinjve, Programi i BE-së për bursa post-diplomike 2009

Zyra Ndërlidhëse e Komisionit Europian (ZNKE) në Prishtinë dhe Agjencia për Koordinimin e Zhvillimit dhe Integritet Europian (AKZHIE) në Zyrën e Kryeministrit të Qeverisë së Kosovës, shpallin hapjen e konkursit për Raundin e 6-të të Skemës së Celulës së të Rinjve (SCR), programi i BE-së për bursa post-diplomike për Kosovë i cili është duke u zbatuar nga SOFRECO SA. Aplikimi është i hapur prej 13 shkurt deri me 30 mars 2009 dhe kandidatëve të suksesshëm do t'iu ofrohet mundësia të aplikojnë në universitetet brenda shteteve anëtare të BE-së të përzgjedhura nga AKZHIE dhe Projekti. Programi i Bursave, **gjuha punuese e të cilit është vetëm ajo angleze**, do të ofroj deri në 50 bursa të plota (numri real i fitimit të bursave mund të jetë edhe më i vogël, varësisht nga përshtatshmëria e kandidatëve dhe mjetet e financuara) për të studiuar në programin Master në universitete brenda shteteve anëtare të BE-së. Nga studentët do të kërkohet të specializojnë në njërin nga fushat vijuese:

- ◇ Juridik (E drejta e përgjithshme e BE-së dhe juristët linguistë) – deri në 15 bursa studimi në dispozicion
- ◇ Financa Publike – deri në 3 bursa studimi në dispozicion
- ◇ Menaxhimi i Pronës Publike – deri në 4 bursa studimi në dispozicion
- ◇ Të drejtat intelektuale, komerciale dhe industriale – deri në 4 bursa studimi në dispozicion
- ◇ Politikat e punës dhe ato sociale – deri në 4 bursa studimi në dispozicion
- ◇ Transport dhe telekomunikim – deri në 4 bursa studimi në dispozicion
- ◇ Bashkëpunimi ekonomik rajonal, Tregu i brendshëm i BE-së – deri në 4 bursa studimi në dispozicion
- ◇ Studime zhvillimore – deri në 5 bursa studimi në dispozicion
- ◇ Veterinari dhe Fitosanitari – deri në 4 bursa studimi në dispozicion
- ◇ Gjeologji/Xehetari – deri në 3 bursa studimi në dispozicion

Të drejtë konkurrimi kanë kandidatët të cilët:

- ◇ Posedojnë letërnjoftim dhe/apo dokument të udhëtimit të UNMIK-ut apo pasaportën e Kosovës apo ata që sigurojnë dëshmi mbi banimin në Kosovë
- ◇ Janë të diplomuar në njërin nga fushat e lartpërmendura. Studentët të cilët janë në përfundim të studimeve poashtu kanë të drejtë konkurrimi nëse marrin diplomën jo më vonë se **30 prill 2009**.
- ◇ Janë të rrjedhshëm në gjuhën angleze dhe shqipe apo serbe. Njohja e gjuhëve tjera të BE-së do të konsiderohet përparësi.
- ◇ Mund të udhëtojnë nga shtatori 2009
- ◇ Janë të lindur më 31 mars 1969 apo më vonë

Bursat do të mbulojnë shpenzimet për deri në **50 bursistë**, si në vijim:

- ◇ Shpenzimet e shkollimit
- ◇ Shpenzimet e jetesës
- ◇ Shpenzimet e vizës
- ◇ Sigurimin shëndetësor
- ◇ Biletat e udhëtimit
- ◇ Testin e gjuhës Angleze IELTS

Pjesëmarrësit e përzgjedhur do të zotohen të:

- ◇ Punojnë për Qeverinë e Kosovës (apo Universitetet Publike apo organe tjera sipas marrëveshjes) si praktikant së paku dy muaj para nisjes
- ◇ Ndjekin dhe kryejnë studimet e zgjedhura post-diplomike
- ◇ Pas kthimit, përmbushin obligimin e punësimit trevjeçar në administratën publike të Kosovës (apo në Universitetet Publike apo organe tjera sipas marrëveshjes ku kjo kërkohet)

Përzgjedhja do të zhvillohet në tri faza të cilat përfshijnë:

- ◇ Përzgjedhja e CV-ve dhe Letrave të Motivimit
- ◇ Testi me shkrim i gjuhës Angleze dhe i njohurive të përgjithshme për BE-në
- ◇ Intervistat nga paneli i akademikëve europianë dhe përfaqësuesve nga ZKNE dhe AKZHEI

Femrat dhe përfaqësuesit e minoriteteve fuqimisht inkurajohen të aplikojnë. Formularët e aplikimit dhe dokumentet tjera përcjellëse mund të shkarkohen nga interneti, në webfaqen vijuese www.ycs2009.eu deri të hënën me 30 mars 2009. Informatat shtesë mbi **rregullat e bursës dhe kriteret e përzgjedhjes janë në dispozicion online dhe duhet të lexohen dhe të jenë të qarta para se të dorëzohet aplikacioni.**

Aplikuesit duhet të plotësojnë **formularin e aplikimit SCR** në **gjuhën angleze**, në **formatin e CV-së Euro pass**, dhe **Letrën e Motivimit** e cila duhet të jetë e datuar dhe nënshkruar me shpjegimin pse dëshironi të merrni pjesë në skemë. Aplikacionit duhet t'i bashkangjiten **kopjet e diplomave apo titujve të fituar dhe Dokumenti i Udhëtimit të UNMIK-ut dhe/apo letërnjoftimi i UNMIK-ut apo ndonjë dëshmi e vendbanimit** në Kosovë apo Pasaporta e Kosovës. Kandidatët të cilët janë në përfundim të studimeve, aplikacionit duhet t'i bashkëngjiesin **kopjen e transkriptit të notave** dhe një **deklaratë të përgatitur nga vetë kandidati lidhur me datën e pritjes të diplomimit**. Sigurohuni që të përfshini në formularin e aplikimit SCR dhe në CV-në **Europass një e-mail adresë të VLEFSHME dhe numër telefoni**.

Formati i CV-së Euro pass dhe formulari i aplikimit SCR mund të shkarkohen nga www.ycs2009.eu duke u regjistruar në webfaqe.

NB: Aplikacionet jo të plota dhe aplikacionet që nuk përfshijnë CV-të në formatin Europass nuk do të shqyrtohen!

Afati për aplikim: të hënën, 30 mars 2009 ora 16:45

Dorëzimi i aplikacionit duhet të bëhet personalisht, çdo ditë, nga e hëna deri të premten, prej orës 10:00 – 16:45 dhe në pliko të mbyllur të adresohet tek: **EU YCS Scholarship Scheme, SOFRECO SA, Rr. Mujë Krasniqi p.n. Ndërtesa e Institutit Kosovar për Administrim Publik (IKAP), Zyra B-11, 10000 Prishtinë, Kosovë**

APLIKACIONET PËRMES E-MAIL NUK JANË TË VLEFSHME

*Ju lutem të mos bëni kërkesa të drejtpërdrejta lidhur me aplikacionin tuaj.
Kandidatët që nuk kontaktohen deri më 6 Prill 2009 nuk kanë arritur të hyjnë në listë të ngushtë.*

Për më shumë informata mund të konsultoni www.ycs2009.eu

Vërejtje: Zbatimi i këtij programi varet nga mundësia e financimit nga BE, menaxhuar nga Zyra Ndërlidhëse e Komisionit European në Kosovë

“Bursat e BE-së në Shërbimin Civil” është projekt i financuar nga BE, menaxhuar nga ZNKE dhe zbatuar nga SOFRECO SA.

